

Kombëtarja vazhdon stërvitjen dhe shpreson kualifikimin

nga Administrator

E martë, 21 Qershor 2016 13:06



Pavaresisht se Shqipëria nuk e di akoma në qofte se do të kualifikohet për më tej, ajo vazhdon stërvitjen. Dje kombëtarja shqiptare ka zhvilluar vetëm një stërvitje. Ajo është zhvilluar në orën 18.00 në kompleksin sportiv në Perros Guirec, ku Shqipëria po përgatitet prej 14 ditësh në finalët e Kampionatit Europian “Francë 2016”. Në këtë stërvitje, nuk morën pjesë futbollistët e formacionit të ndeshjes kundër Rumanisë. Këtij grupi i është bashkuar edhe Ergys Kaçe i cili ndjente dhimbje të forta barku dhe është lënë pushim nga ana e stafit mjekësor.

Të gjithë të tjerët, u vunë në dispozicion të trajnerit Gianni De Biasi dhe ndihmësve të tij. Futbollistët u stërvitën fillimisht me disa sprinte të lehta dhe ushtrime të tjera për të kaluar në pjesën e ushtrimeve të ndryshme taktike. Ajo ka zgjatur për rreth 80 minuta. Pastaj futbollistët janë larguar për në rezidencën e tyre në hotel “L’Agapa”.